

NJOFTIM

MBI ORGANIZIMIN E EVENTIT "OPEN PORT" NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

Autoriteti Portual Durrës, person juridik publik i cili funksionon në bazë të Ligjit 9130, dt. 08.09.2003 "Për Autoritetin Portual" dhe V.K.M Nr. 596, datë 10.09.2004 "Për miratimin e Statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe riorganizimin e tij";

Njofton për fillimin e procedurave të Konkurimit publik për Organizimin e Eventit "Open Port" në APD Autoriteti Portual Durrës, ndjek këtë procedurë në përputhje me VKM nr.1173 datë 06.11.2009 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura", për përzgjedhjen e një operatori të specializuar për realizimin e kontratës.

1. Objekti i kësaj kontrate përcaktohet në :

Organizimin e eventit artistiko-kulturor "Open port" (ditët e hapura në Autoritetin Portual Durrës)

Kriteret për organizimin e këtij eventit përcaktohen si më poshtë:

- ❖ *Kryerja e aktiviteteve të ndryshme artistike kulturore brenda territorit të portit, ku përfshihen:*
- ❖ *Shëtitja me mjete të ndryshme alternative e vizitorëve nëpër ambientet operacionale të portit.*
- ❖ *Promovim i aktivitetit të APD-së nëpërmjet vendosjes së projektorëve në të dy hyrjet e portit, të cilët do të shfaqin informacione dhe imazhe nga historiku i portit.*
- ❖ *Aktivitete shumëngjyrëshe për fëmijë si psh shfaqje nga cirku i Tiranës, ose/dhe performancë nga grupi i fëmijëve "Kripëmjaltëzat", me anë të kërcimit, aktrimit duke organizuar dhe lojëra të ndryshme për të sjellë një atmosferë festive.*
- ❖ *Aktivitete për të rinj, ku të përfshihen numra me anë të balerinëve profesionistë nën ritmet e muzikës bashkëkohore, si dhe valle nga ansambli popullor i valleve.*
- ❖ *Pjesëmarrje në këtë aktivitet i dy maskotëve, i një facepainteri, i cili do të pikturojë në fytyrë fëmijët pjesëmarrës.*
- ❖ *Vendosja e një videoprojeksi në një nga hapësirat e portit, i cili do të funksionojë si një kinema verore, ku do të transmetohen filma për të gjitha grupmoshat.*
- ❖ *Sigurimi i shërbimeve për pije dhe ushqime (catering) për të pranishmit.*
- ❖ *Pjesëmarrja e operatorëve, subjekteve privatë që punojnë në ambjentet e portit (agjensi, investitorë, etj)*

2. Fondi limit për realizimin e kësaj kontrate, vënë në dispozicion nga Autoriteti Portual Durrës është 5 000 000 lekë (pesëmilion) pa tvsh .
3. Kriteret për realizimin e këtij eventit përcaktohen si më poshtë :
 - ❖ Përmbajtja e një programi të mirëstudiuar në lidhje me organizimin e eventit .
 - ❖ Promovimi i eventit nëpërmjet fletëpalosjeve, spoteve publicitare, reklamimit në ambiente publike të qytetit.
 - ❖ Metodologjinë e realizimit të eventeve, e cila do të përfshijë zgjidhjet teknike dhe përcaktimin e qartë të kryerjes së aktiviteve, si dhe kohën e realizimit të tyre.
4. Ofertuesi, pjesëmarrës në këtë procedurë duhet të dorëzojë dokumentacionin e nevojshëm ligjor, financiar dhe teknik si më poshtë :

- ❖ Dokumentacioni ligjor :

Një dokument që vërteton se subjekti:

- a) nuk është në proces falimentimi,
- b) nuk është dënuar për shkelje penale,
- c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional, të lëshuar nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

Një dokument që vërteton se kapitalet/asetet e subjektit nuk janë në duart e përbaruesit gjyqësor apo ekziston një urdhër sekuestroje për to, lëshuar nga Zyra e Përbarimit.

- ❖ Dokumentacioni financiar :

Oferta ekonomike në të cilën të përfshihen elementët e çmimit të ofertës për

-Eventin , përfshirë të gjitha aktivitetet e cituara në këtë njoftim

- ❖ Dokumentacioni Teknik :

a)Një përshkrim i detajuar i profilit të shoqërisë, Cv e stafit dhe kompanisë, punë të realizuara gjatë viteve të fundit.

b) Një përshkrim i detajuar i kërkesave teknike dhe projekt idesë për realizimin e eventit.

- ❖ Dokumentat e kërkuara duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

5. Kriteret për vlerësimin e ofertave të paraqitura:

Ofertat të cilat kualifikohen duke plotësuar kërkesat ligjore, teknike dhe financiare të do të vlerësohen në përputhje me kriterin e përcaktuar :

1.Përvoja në organizimin e ngjarjeve.

2.Cmimin më të ulët të ofruar nga operatorët për realizimin e eventit.

6. Afati përfundimtar për dorëzimin dhe hapjen e ofertave do të jetë data 01.06.2011, ora 11:00 .
Afati përfundimtar për hapjen e ofertave do të jetë data 01.06.2011, ora 11:00, vendi: salla e mbledhjeve e Drejtorisë së Autoritetit Portual.
Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hapjes së ofertave.
7. Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf , të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë Drejtorisë Ekzekutive të Autoritetit Portual ose dorazi para komisionit në datën dhe orën e përcaktuar.
8. Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë e cila do të dorëzohet tej afatit të përcaktuar dhe jo në përputhje me kërkesat.